



V E N D I M
K.P.P. 158/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k dhe “Eurogjici Security” shpk, në procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr. Ref-41648-01-23-2018, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes me roje private të objektit të Spitalit Psikiatrik Elbasan”, me fond limit 2.916.550,75 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Psikiatrik “Sadik Dimçi” Elbasan.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” shpk, “Bahiti G” sh.pk dhe “Security Ranis” sh.p.k.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” shpk, “Bahiti G” sh.p.k “Security Ranis” sh.p.k dhe “Kumria 1” sh.p.k.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Uevi 2015” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Bahiti G” sh.p.k
L. “Aqif Pasha”, Rr. “Rinia”, Pall. 495/1, Kati 3 ,
Elbasan

“Kumria 1” sh.p.k
Lagja “11 Nëntori”, Rruga “Sh. Daiu”, Banesa Nr.21,
Elbasan

“Nazeri 2000” sh.p.k
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II,
Tiranë

“Eurogjici Security” sh.p.k
Rruga “Adem Jashari”, L.8, H.10, Ap.3
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Psikiatrik “Sadik Dimçi” Elbasan
Lagja “Haxhias, Rruga “Ismail Zyma”,
Elbasan

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 24.01.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr. Ref-41648-01-23-2018, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes me roje private të objektit të Spitalit Psikiatrik Elbasan”, me fond limit 2.916.550,75 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Psikiatrik “Sadik Dimçi” Elbasan.

II.2. Në datën 07.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezultoni si më poshtë vijon:

1. “Uevi 2015” sh.p.k	7988,00 lekë, kualifikuar
2. “Eurogijci Securiy” sh.p.k	7988,21 lekë, kualifikuar
3. “Bahiti G” sh.p.k	7988,83 lekë, kualifikuar
4. “Security Ranis” sh.p.k	7988,90 lekë, kualifikuar
5. “Kumria 1” sh.p.k	7989,07 lekë, kualifikuar
6. “Nazeri 2000” sh.p.k	7990,45 lekë, kualifikuar
7. “Aulona Pol 1” sh.p.k	7990,55 lekë, kualifikuar
8. “Myrto Security” sh.p.k	7990,59 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 12.02.2018 operatori ekonomik ankimues “Bahiti G” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“Oferta e operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k me vlerë 7.988 lekë pa tvsh dhe “Eurogijci Security” sh.p.k me vlerë 7.988,21 lekë pa tvsh, për një vendroje me tre turne në ditë, janë të parashikuara nën kostot ligjore të percaktuara dhe si të tilla duhet të skualifikohen [...]”

II.3.1. Në datën 13.02.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit nëpërmjet shkresës nr 10/11 prot., datë 12.02.2018, duke e refuzuar ankesën.

II.3.2. Në datën 14.02.2018 operatori ekonomik “Bahiti G” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.3.3. Në datën 23.02.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 237/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 10/17 prot., datë 21.02.2018 me objekt: “Mbi vendimin tuaj nr.237/1 prot., datë 15.02.2018”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.4. Në datën 10.02.2018 operatori ekonomik ankimues “Kumria 1” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar vijon:

“[...] Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë operatorët ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k, dhe “Security Ranis” sepse, në kundërshtim me kërkesat sqarime të formularit të ofertës, kanë paraqitur ofertë ekonomike nën koston ligjore të lejuar. Nuk kanë paraqitur analizë kostoje të detajuar të zërave të preventivit për tui shmangur vlerave reale faktike, nuk kanë llogaritur drejt shpenzimet për pagën bazë për një vëndroje me tre turne në ditë, me 4,98 roje në muaj, me koeficient zëvëndësimi 1.66 për cdo punonjës shërbimi, me pagë referuese 36.000 lekë. Nuk kanë respektuar dispozitat ligjore në fuqi në përlloagritjen e zërave të shpenzimeve të turneve të II-ta dhe III-të, për rrjedhojë detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore e shëndetësore në masën 16,7%. Këta opertaorë në llogaritjen e zërave të shpenzimeve të preventivit kanë bërë manovra me shifrat, nuk kanë zbatuar metodikën e veprimeve matematikore, duke ulur vlerën në zërat e koston ditore në mënyrë artificiale, duke sjellë tjetërsimin e vlerës së ofertës [...]

Gjithashtu pretendohet se operatori ekonomik “Uevi 2015” sh.p.k nuk plotëson kërkesat për kualifikim si vijon:

- 1. Nuk ka paraqitur xhiron mesatare vjetore për vitin 2017.*
- 2. Nuk ka paguar detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i rregjistruar në Shqipëri sipas kërkesave të ligjit.*
- 3. Nuk ka paraqitur Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorim të frekuencave për radiokomunikim e alarm me zonë mbulimi Elbasan”.*

II.4.1. Në datën 12.02.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit nëpërmjet shkresës nr 10/13 prot., duke e refuzuar ankesën.

II.4.2. Në datën 19.02.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.4.3. Në datën 05.03.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 275/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 122/1 prot., datë 02.03.2018 me objekt: “Kthim përgjigje”.

II.5. Në datën 12.02.2018 operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k, “Security Ranis” sh.p.k dhe “Kumria 1” sh.p.k pasi:

1. *Nuk kanë parashikuar pagën minimale ligjore, shtesat turni II dhe III si dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
2. *Nuk kanë paraqitur analizë kosto, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.*
3. *Nuk kanë certifikata të vlefshme brënda afatit 4 vjeçar për numri e punonjësve të kërkuar nga autoriteti kontraktor.*
4. *Nuk kanë paraqitur vërtetim xhiro për vitin 2017*
5. *Nuk kanë paraqitur autorizim për blerje arme, kontratë blerje dhe fatura për armë, ku të vërtetojnë se kanë në pronësi të tyre armë, për përmbushjen e kërkesës së dhënë në dokumentat e tenderit.*

II.5.1. Në datën 14.02.2018, nëpërmjet shkresës nr. 10/9 protokolli datë 12.02.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.5.2. Në datën 23.02.2018 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor përsa i përket pretendimeve nga pika 1 – 4. Nuk është paraqitur pretendim për armën.

II.6. Në datën 09.02.2018 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e shoqërisë “Uevi 2015” sh.p.k pasi, sipas tij, ka paraqitur ofertë nën koston ligjore.

II.6.1 Në datën 14.02.2018, nëpërmjet shkresës nr. 10/7 protokolli datë 12.02.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën.

II.6.2. Në datën 23.02.2018 ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “Bahiti G” sh.p.k se: *“oferta e operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k me vlerë 7.988 lekë pa tvsh dhe “Eurogjici Security” sh.p.k me vlerë 7.988,21 lekë pa tvsh, për një vendroje me tre turne në ditë, janë të parashikuara nën koston ligjore të përcaktuara dhe si të tilla duhet të skualifikohen’*; pretendimin e shoqërisë “Kumria 1” sh.p.k se: *“operatorët ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k, dhe “Security Ranis” duhet të skualifikohen sepse në kundërshtim me kërkesat sqarime të formularit të*

ofertës, kanë paraqitur ofertë ekonomike nën koston ligjore të lejuar [...]; pretendimin e shoqërisë “Nazeri 2000” shp.k se: “shoqëritë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k, “Security Ranis” dhe “Kumria 1” sh.p.k kanë paraqitur ofertë ekonomike nën koston ligjore të lejuar lidhur me shpenzimet për pagën bazë, shpenzimet e turneve të II-ta dhe III-të, e sigurimet shoqërore e shëndetësore [...]; pretendimin e shoqërisë “Eurogjici Security” shp.k se: “shoqëria “Uevi 2015” sh.p.k ka paraqitur ofertë nën koston ligjore”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi

ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.1.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomik – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përlogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.1.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta. Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.1.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore, duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht, duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, në pjesën “Sqarim”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

Sqarime:

1. *Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.*
2. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.*

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me 2 turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017,” Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.*

- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

Ndërkohë në shtojcën 6, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 6 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

“Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin **analizen e kostos per oferten e paraqitur**. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)”.

Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit është parashikuar shërbimi si vijon:

“Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në një vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.”

Në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit të dokumentave të tenderit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Shërbimi i ruajtjes me roje private te godines se “Spitalit Psikiatrik dr.Sadik Dinci, Elbasan” në 1 vendroje me 4.98 roje gjithsej– Marrveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit: _____

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimet
1	3	4.98	12 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit u ka kërkuar të gjithë ofertuesve që:

- të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore;
- si dhe gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore në vlerën prej 36.000, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë; si dhe
- kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%.

Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me

të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesit, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë dhe konkretisht elementëve bazë (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) – elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST-; gjykon se operatori ekonomik “Kumria 1” shpk, ka respektuar dispozitat ligjore për pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%.

Komisioni sqaron se ka qënë detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatori ekonomik i lartpërmendur ka përmbushur detyrimet bazë për një ofertues, siç janë llogaritja saktë e pagës bazë minimale ligjore, shtesave mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën dhe vlerat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik, pasi mori në shqyrtim ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k dhe “Security Ranis” sh.p.k, konstaton se ofertat për një vendroje (të cilat përbëjnë një element në ofertën totale referuar kohëzgjatjes së shërbimit), të paraqitur nga këto subjekte, rezultojnë të jenë nën minimumin e lejuar ligjor të këtij shërbimi, ndërsa nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të shoqërisë “Kumria 1” sh.p.k rezulton se kjo ofertë është në minimumin ligjor.

Në sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Bahiti G” sh.p.k për shoqëritë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Kumria 1” sh.p.k për shoqëritë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k dhe “Security Ranis” sh.p.k, qëndron.

“Pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k qëndron për shoqëritë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k dhe “Security Ranis” sh.p.k, dhe nuk qëndron për shoqërinë “Kumria 1” sh.p.k.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k, për shoqërinë “Uevi 2015” sh.p.k, qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Kumria 1” sh.p.k përse i përket operatorit ekonomik “Uevi 2015” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit të mësipërm në pikën III.1 të arsyetimit, gjendja faktike dhe juridike e këtij subjekti do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesat e ankimuesit.

III.3. Gjithashtu lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k përsa i përket shoqërive “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k dhe “Security Ranis” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit të mësipërm në pikën III.1 të arsyetimit, gjendja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomikë në fjalë do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesat e ankimesit.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k se shoqëria “Kumria 1” sh.p.k “nuk ka paraqitur analizë kosto, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, në pjesën “Sqarim”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Sqarime:

3. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
4. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me 2 turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mësipërm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vëndroje me tre turne të llogaritet **4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore)**. Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomikë ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Ndërkohë në shtojcën 6, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 6 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **analizen e kostos per oferten e paraqitur**. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)”.

Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit është parashikuar shërbimi si vijon: “Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në një vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.”

Në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit të dokumentave të tenderit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Shërbimi i ruajtjes me roje private të godines së “Spitalit Psikiatrik dr.Sadik Dinci, Elbasan” në 1 vendroje me 4.98 roje gjithsej– Marrveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit: _____

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
1	3	4.98	12 muaj Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të prokurimeve, rezulton se operatori ekonomik “Kumria 1” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër, bashkëngjitur formularit të ofertës, ka paraqitur analizën e kostos në ditë për një roje dhe një vendroje me tre turne.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimet e kryera në SPE në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Kumria 1” shpk, në plotësim të kriterit të sipërcituar, si dhe duke ju referuar shtojcës 6 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 6, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi ku autoriteti kontraktor është shprehur në mënyrë eksplicite

“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **analizen e kostos per oferten e paraqitur** sipas shtojcës 1- sqarime”, konstaton, se është dorëzuar analiza e kostos me të gjithë elementët e parashikuar në sqarimin e dhënë në formularin e ofertës, si më sipër cituar.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Nazeri 2000” shpk nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k se *operatori ekonomik “Kumria I” sh.p.k nuk ka certifikata të vlefshme brënda afatit 4 vjecar për numri e punonjësve të kërkuar nga autoriteti kontraktor*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në Shtojcën 6/2, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë*”, pika 3 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 5 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Elbasan;”.

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese;”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.

III.5.3. Në nenin 5 të Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, parashikohet shprehimisht se: 1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. 2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut. 3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së. 4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim. 5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik **dhe punonjësën e shërbimit**.

III.5.4. Neni 7 “Kategoritë e licencës” i ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, parashikon shprehimisht se:

“Licencat, sipas këtij ligji, ndahen në dy nënkategori:

a) nënkategoria I.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike”, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit;

b) nënkategoria I.3.B, “Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit”, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit”.

III.5.5. Ndërsa Neni 9 “Llojet e certifikatave” i ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, parashikon shprehimisht se:

“1. Certifikatat për titullarin e SHPSF-së, për drejtuesin teknik dhe për punonjësën e shërbimit ndahen në lloje, sipas nënkategorive të licencës.

2. Çdo i interesuar për punonjës shërbimi të SHPSF-së ka të drejtë të pajiset me certifikatë, sipas nënkategorive të licencave”.

III.5.6. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik “Kumria 1” shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- 1. Shkresën me nr.153 prot., datë 08.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, ku përcaktohet numri i punonjësve të shërbimit të certifikuar 108 punonjës si dhe lista emerore e tyre, shoqëruar me të dhëna për nr.certifikatës dhe datën e lëshimit të saj për secilin nga punonjësit e certifikuar të listës emerore të subjektit “Kumria 1” shpk.*
- 2. Dhjetë (10) certifikata për punonjës shërbimi, të cilat rezultojnë në listën emerore të vërtetimit nr.153 prot., datë 08.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan.*

III.5.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46, pika 1, gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [....]”.

III.5.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, kriterit të përcaktuar në DST për dorëzimin nga operatorët ekonomikë të të paktën 5 certifikatave për punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Elbasan si dhe, duke iu referuar verifikimit të kryer në SPE, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Kumria 1” shpk është në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, duke vërtetuar se disponon një numër më të madh se minimumi prej 5 certifikata punonjësish të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni sqaron gjithashtu se lista

emërore e punonjësve, në vërtetimin e DPV, përmban informacion lidhur me datën e lëshimit të certifikatave në fjalë, të cilave nuk u ka kaluar afati i parashikuar në ligj.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues “Kumria 1” shpk ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi vërteton se zotëron kapacitetin teknik në lidhje me certifikatat profesionale sipas përcaktimit të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k se shoqëria “Kumria 1” sh.p.k nuk ka paraqitur vërtetim xhiro për vitin 2017, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në Shtojcën 6 “ Kriteret e vecanta të tkualifikimit ”, “Kapaciteti ekonomik e financiar”, është kërkuar:

“Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit te ketë një vlere sa fondi limit i Marrveshjes Kuader. Për ketë operatori ekonomik duhet te paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.”.

III.6.2. Nga verifikimi i ofertës së shoqërisë “Kumria 1” sh.p.k rezulton se është paraqitur vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit 2015, 2016 dhe 2017 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan në datën 03.02.2018. Sipas këtij dokumenti, të ardhurat nga shitja e mallrave/shërbimeve është si më poshtë:

1. Periudha tatimore 17-A	Shuma 107.295.910
2. Periudha tatimore 16-A	Shuma 94.158.210
3. Periudha tatimore 15-A	Shuma 61.418.903

III.6.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike, në lidhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor për plotësimin e xhiros mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit rezulton se, xhiro mesatare gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të shoqërisë “Kumria 1” sh.p.k, është mbi 2.916.550,75 lekë.

III.6.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “c” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese; Gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.6.5. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur, personel, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.6.6. Bazuar në sa më sipër KPP dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kumria 1” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për xhiron mesatare të tre viteve të fundit si më sipër cituar.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” nuk qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bahiti G” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr. Ref-41648-01-23-2018, me objekt: *“Shërbimi i ruajtjes me roje private të objektit të Spitalit Psikiatrik Elbasan”*, me fond limit 2.916.550,75 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Psikiatrik “Sadik Dimçi” Elbasan.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kumria 1” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Uevi 2015” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Bahiti G” sh.p.k dhe “Security Ranis” sh.p.k, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta ofertues.

6. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Bahiti G” sh.p.k, “Kumria 1” sh.p.k dhe “Eurogjici Security” sh.p.k.
8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 237 Protokolli;	Nr. 275 Protokolli;	Nr. 340 Protokolli;	Nr. 345 Protokolli
Datë 14.02.2018	Datë 19.02.2018	Datë 23.02.2018	Datë 23.02.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

